REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2748/ 10 prot. Datë 23/12/2025

V E N D I M
Nr. 1901/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23/12/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1727/2025, datë 20.11.2025 për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-62796-09-26-2025*, me objekt: "*Riparim dhe mirëmbajtje automjete ndarë në 3 (tre) lote*", me fond limit 30,711,973 (*tridhjetë milion e shtatë qind njëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e shtatë dhjetë e tre*) Lekë pa TVSH ose 317,206.91 (*treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një*) Euro pa TVSH, Loti 3, me numër reference Nr: *REF-62812-09-26-2025*, me objekt: "*Shërbim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës*", me fond limit të lotit : 9.250.000 (*nëntë milion e dy qind e pesë dhjetë mijë*) Lekë pa TVSH ose 95,538.111 (*nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë njëqind e njëmbëdhjetë*) Euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik "*VILNIK MOTORS*" SHPK me NIPT: L01314031G dhe me adresë: *Rruga e Kavajes, Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2 , Km 6, LALM Vaqarr, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Godina nr.6/337 Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1726/2025, datë 20.11.2025, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "VILNIK MOTORS" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar" me numër reference Nr. REF-62796-09-26-2025, me objekt: "Riparim dhe mirëmbajtje automjete ndarë në 3 (tre) lote", me fond limit 30,711,973 (tridhjetë milion e shtatë qind njëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e shtatë dhjetë e tre) Lekë pa TVSH ose 317,206.91 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) Euro pa TVSH, Loti 3, me numër reference Nr: REF-62812-09-26-2025, me objekt: "Shërbim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës", me fond limit të lotit : 9.250.000 (nëntë milion e dy qind e pesë dhjetë mijë) Lekë pa TVSH ose 95,538.111 (nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë*

pikë njëqind e njëmbëdhjetë) Euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

2. *Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*

3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*

4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "VILNIK MOTORS" SHPK.*

5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3030/27 prot., datë 18.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2748/7 prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A, informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me zbatimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1727/2025, datë 20.11.2025, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-62796-09-26-2025,* me objekt: "*Riparim dhe mirëmbajtje automjete ndarë në 3 (tre) lote*", me fond limit 30,711,973 (*tridhjetë milion e shtatë qind njëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e shtatë dhjetë e tre*) Lekë pa TVSH ose 317,206.91 (*treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një*) Euro pa TVSH, Loti 3, me numër reference Nr: *REF-62812-09-26-2025*, me objekt: "*Shërbim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës*", me fond limit të lotit : 9.250.000 (*nëntë milion e dy qind e pesë dhjetë mijë*) Lekë pa TVSH ose 95,538.111 (*nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë njëqind e njëmbëdhjetë*) Euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3030/27 prot., datë 18.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2748/7 prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A, informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me zbatimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 1727/2025, datë 20.11.2025, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-62796-09-26-2025*, me objekt: "*Riparim dhe mirëmbajtje automjete ndarë në 3 (tre) lote*", me fond limit 30,711,973 (*tridhjetë milion e shtatë qind njëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e shtatë dhjetë e tre*) Lekë pa TVSH ose 317,206.91 (*treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një*) Euro pa TVSH, Loti 3, me numër reference Nr: *REF-62812-09-26-2025*, me objekt: "*Shërbim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës*", me fond limit të lotit : 9.250.000 (*nëntë milion e dy qind e pesë dhjetë mijë*) Lekë pa TVSH ose 95,538.111 (*nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë njëqind e njëmbëdhjetë*) Euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1726/2025, datë 20.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,* nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-62796-09-26-2025*, me objekt: "*Riparim dhe mirëmbajtje automjete ndarë në 3 (tre) lote*", me fond limit 30,711,973 (*tridhjetë milion e shtatë qind njëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e shtatë dhjetë e tre*) Lekë pa TVSH ose 317,206.91 (*treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një*) Euro pa TVSH, Loti 3, me numër reference Nr: *REF-62812-09-26-2025*, me objekt: "*Shërbim për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës*", me fond limit të lotit : 9.250.000 (*nëntë milion e dy qind e pesë dhjetë mijë*) Lekë pa TVSH ose 95,538.111 (*nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë njëqind e njëmbëdhjetë*) Euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	**Anëtar**	**Anëtar**
Anila Malaj	**Kreshnik Ternova**	**Gjergj Mersini**

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2025.12.24
04:13:17

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i
Prokurimit Publik
Date:2025/12/24 16:11:41 +02'00'
0f6d634b841143c59f673bc6cb7273dc2

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)